



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 143/14
Prishtinë, më 19.02.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Albana Fetoshi.

Munguan: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Muhamet Musafa dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj Ministër i Financave, Enis Spahiu dhe Liridon Maksuti nga MF, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Zëvendës -kryetari i parë i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 29.01.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Naser Osmani: konstatoi se rendi i dites miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 29.01.2014

Naser Osmani: konstatoi se miratohet procesverbali i mbledhjes se kaluar miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

Naser Osmani: theksoi se tashmë kemi ratifikuar dy marrëveshje që parasheh humarrjen për financimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë, dhe kjo marrëveshje është e natyrë së tillë.

Besim Beqaj sqaroi se përveç marrëveshjes që është ratifikuar me OPEC-un, me qëllim të financimit të rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, është nënshkruar marrëveshja me Fondin Saudit për Zhvillim. Kushtet e kredisë, janë 60 milion sauderial që është ekuivalente me 16 milion dollar, ndërsa nomra e interesit është 2%. Kjo nuk është kredi me kamatë, është vetëm tarif administrative prej 2%. Duke marrë parasysh se projekti është i rëndësishëm së veçantë, dhe dy marrëveshje tjera tashmë i kemi të ratifikuara në Kuvend, edhe kjo marrëveshje është në drejtim të përmbylljes financiare për zgjerimin e rrugës në drejtim të Mitrovicës. Kostoja financiare është në buxhetin e Kosovës dhe është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës.

Naser Osmani: pyeti a është kjo kredia e fundit apo kemi nevojë të marrim hua ende për këtë projekt.

Besim Beqaj: në përgjigje të parafolësit, njoftoi se kjo është kredia e fundit për këtë projekt, që është financuar nga tri organizata dhe besojë që e përmbyllim në aspektin financiar të projektit.

Hykmete Bajrami: thekson se disbursimi apo afati i fundit ish paraparë deri në shkurt të vitit 2018, por këto afate mu duken se e disbursojnë pak përfundimin e projektit. A bëni disbursimin me situacione apo si bëhet disbursimi?

Albana Fetoshi: thekson se sa here që vijnë marrëveshja ndërkombëtare në Kuvend për ratifikim, kanë të bëjnë me financimin e projekteve për ndërtimin e rrugëve, dhe në këtë drejtim kam një sugjerim për qeverinë se kur nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare, fokusimi të jetë edhe për projektet që financohen sektorë tjerë ekonomik, dhe jo vetëm në rrugë e në magjistrale. Kishte qenë më mirë me të fokusoheni në sektorë të cilët do të ndihmonin prodhimin më shumë, për shkak se prodhimi sjellë mirëqenie dhe janë qytetarët që drejtëpërsëdrejti përfitojnë prej tij.

Besim Beqaj: sqaroi se janë bërë marrëveshje për financimin e projekteve të ndryshme dhe në sektorë të ndryshëm. Vitin e kaluar e kemi pas marrëveshjen për Prizrenin që ka qenë në shumë e saj 22 milion për financim, e cila një pjesë është grand një pjesë kredi e butë që ka për qëllim trajtimin e ujërave të zeza në këtë komunë. Njëkohësisht është bërë marrëveshja edhe për komunën e Gjakovës që është në vijim e sipër, e shuma e saj është dikur rreth 20 milion. Me Bankën Botërore kemi arritur një marrëveshje e cila është e raportuar në buxhet dhe ka shumën prej 25 milion dollar për sektorin e shëndetësisë, po ashtu kemi shumë përkrahje financiare për sektorin e bujqësisë, në heqjen e TVSH së për produkte bujqësore. Në vitin e kaluar për herë të parë kemi shënuar rritje të eksportit më shumë se të importit.

Albana Fetoshi: pyeti në cilët sektor kemi rritje të eksportit dhe në cilat fusha?

Besim Beqaj: në përgjigjen e parafolëses, sqaroi se nëse kërkohet specifike duhet të kemi ministrin e tregëtisë dhe industrisë këtu sepse nuk kam kompetencë me folë për këtë. Eksporti ka shënuar rritje në produktet bujqësore dhe kemi ndërrmarje të cilat kanë bërë hapa mjaft të fuqishme në tregjet evropiane. Po ashtu kemi rritje të eksportit për ujë dhe pije joalkoolike, lëkura, tek mineralet etj.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryesuesi i komisionit, konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua për projektin e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Naser Osmani sqaroi se kemi të bëjmë me një projektligj që ka nxitur debat të gjërë. Në një takim që është mbajtur në mes përfaqësuesit të BE-së, kryetarit të Kuvendit, anëtarëve të Kryesisë, shefave të grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve parlamentare, kam marrë pjesë edhe unë që kam zëvendësuar kryetaren e komisionit, dhe me rastin e diskutimit për këtë qështje, nga z. Zhbogar kam kuptuar se kjo qështje është negociuar me qeverinë dhe projektligji si ka ardhur e ka marrë dritën e gjelbërt nga Bashkimi Evropian, që kjo qështje të jetë kështu në një periudhë 3 deri 5 vjeqare. Është arsyetuar se një zgjidhje e tillë është edhe në disa shtete të rajonit. Nga ana tjetër kemi marr një letër nga EULEX, që sugjeron që projektligji të mos aprovohet pasi që është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së në qështjen e trajtimit të barabarësisë dhe konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit. Ajo që kam shpreh si shqetësim se në të ardhmën kur do të bëhet raporti i progresit do të mund të përmendet si diçka negative për Kosovën dhe kam marrë mesazhin se kjo nuk do të ndodhë, pasi që është bërë me marrëveshje dhe nëse kjo nuk përmendet si diçka negative në këtë raport, do të ishte mirë me e përkrah draftin siç ka ardhur nga qeveria.

Latif Gashi: sqaroi se si grup punues nuk kemi pas rast me u taku me Zyrën e Zhbogarit, por kemi pas dy shkresa zyrtare, njëren prej EULEX-it, e tjetrën prej Ministrisë së Integrimeve Evropiane. Në shkresën e EULEX-it është thënë se projektligji është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, por dilemat na ka hequr shkresa e MIE, që sqaron se janë harmonizuar me zyrën e BE-së. Po ashtu kemi diskutuar rekomandimet e deputesë Hykmete Bajramit edhe Albana Fetoshi, që kanë pasur pothuajse të njëjtën përmbajtje, që kanë kërkuar të përveq kompanive shërbimeve të futen edhe prodhimet vendore. Po ashtu pak me vonësë kemi pranuar dy propozime nga zyra e kryeministrit, që nuk kemi arritur ti trajtojmë si grup punës dhe ka mbetur të vendos komisioni. Si dhe duhet të ndryshohet neni 3 sa i përket afatit të hyrjes në fuqi të ligjit që duhet të jetë 15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare.

Albana Fetoshi: theksoi se kemi punuar si grup punues dhe nuk kemi vendosur asgjë pasi që e kemi lënë të vendos komisioni. Unë kam propozuar një amendament, i cili do të votohet edhe në seancë dhe ka për qëllim që ky ligj ti favorizojë prodhimet vendore. Po e lexoj amendamentin: Në çdo rast kur vije deri te zbatimi i kriterit për çmimin më të ultë të ofruar dhe kur kemi të bëjmë me ofertuesit vendor dhe të huaj lidhur me

kontratat për furnizim, autoriteti kontraktues përzgjedhë ofertën e prodhësitor vendor me kusht që çmimi i këtij ofertuesi të mos jetë më i lartë se 20% në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofertuesi i huaj.

Ne biseduam edhe më herët për hendekun e madhë në mes eksportit dhe importit dhe vërejmë se produktet e importit janë ato që po mbysin prodhimin vendor. Prandaj përkrahja e prodhuesve vendorë, do të ndikonte edhe në zvogëlimin e hendekut në mes eksportit dhe importit. Ne po kërkojmë që në të gjitha rastet në procesin e tenderimit kur merrë pjesë një prodhues vendor, të ketë përparësi në kushtet e dhënies së tenderit. Thatë se ky amendament është në kundërshtim me praktikën e BE-së, por pikërisht pse vendet e bashkimit Evropian nuk e kanë menduar një praktikë të tillë është për arsye se ata nuk kanë nevojë për një gjë të tillë sepse atje mjafton që të favorizohen kompanitë vendorë. Kjo për faktin se shumica e prodhimeve i kanë vendet. Projektligji siç është propozuar nga qeveria është në kundërshtim edhe me praktikën e vendeve të BE-së. Vendet që nuk e kanë të rregulluar në legjislacionin e tyre favorizimin e prodhimeve vendorë, për shkak se prodhimi vendor në shumicën e këtyre vendeve mbizotëron tregun.

Latif Gashi: theksoi se realisht nuk qendron ajo që po thotë kolegja Fetoshi. Grupi punues ka marrë vendim që projektligji të mbetet i pa ndryshuar, ndërsa komisioni të vendos për rekomandimet e e propozuar nga dy anëtarët e komisionit.

Besim Beqaj: theksoi se është një amendament i një ligji shumë të rëndësishëm në një situatë shumë delikate kur ne jemi në negociatë me Bashkimin Evropian për marrëveshjen e stabilizim-asociimit. Po të hyjmë në detaje të amendamenteve që kanë ardhur nga qeveria, kuptojmë se ndërmarrjet tregtare duhet me pas një nënkontraktues i cili konsiderohet që është ndërmarrje vendorë. Favorizimi i cili bëhet për momentin nuk është favorizimi i konsumatorit, por kjo po bëhet për të përkrahur aktivitetin ekonomik vendor që janë kontraktuesit dhe nënkontraktuesit që është në funksion të hapjes së vendeve të punës dhe zhvillimit të një ekonomie me një potencial për eksport.

Naser Osmani: thekson se qështja e konsumit të produkteve vendorë është qështje e kulturës dhe e vetëdijes qytetare. Shteti mundet me të stimulue produktet vendorë, por shteti nuk me ndikue në konsumimin e produkteve vendorë. Për interesin e Kosovës, më e rëndësishme është me pas përparësi prodhimet vendorë dhe jo kompanitë dhe fundja Kosova edhe me Kushtetutë garanton një treg dhe konkurrencë të lirë.

Hykmete Bajrami: thekson se në leximin e parë të projektligjit, kam kritikuar që propozimi i qeverisë nuk ka qenë i mbështetur me shifra. Janë dikur 900 milion euro të buxhetit që shpenzohen përmes prokurimit publik dhe nuk e dijmë sa ka qenë pjesëmarrja e kompanive të huaja në këtë shumë, pra nuk kemi informata sa para të buxhetit të Kosovës kanë dalë jashtë vendit dhe sa po dëmtohen kompanitë vendorë apo edhe ofertuesit vendor. Me propozimin që ka ardhur nga Qeveria nuk është e qartë se do të ndihmohen prodhimet vendorë, sepse qasja është te kompanitë dhe jo të prodhimet vendorë, prandaj kjo ka pasur nevojë të qartësohet më mirë.

Besim Beqaj: theksoi se personalisht përkrah propozimet që dëshirohet të bëhet diçka më mirë, por por friksohem se mos po e prishim krejt. Nëse ne si qeveri nuk kemi bërë punën si duhet dhe nëse Kuvendi mendon se mundet me ndërrue qasjen për këtë qështje unë do ta mbështes plotësisht.

Naser Osmani: projektligji është i qartë, përparësia iu ipet firmave vendorë dhe ska të bëjë me produktet vendorë, ka të bëjë vetë me kontraktor jo me biznese.

Hykmete Bajrami: theksoi se është e nevojshme të bëhet dallimi në mes kompanive dhe produkteve vendorë. Siç e cekim edhe më lartë, në një proces të prokurimit, mund të kemi kemi kompani vendorë me që

do të ofertojnë me ndonjë prodhim të huaj edhe kemi kompani vendore që oferton me një produkt vendorë dhe kjo nuk është e njëjta, prandaj ndryshimet dhe plotësimet siç janë propozuara nuk janë të qarta.

Xhevdet Neziraj: në takimin e grupit punues, kam porpozue që rekomandimet të vendosen në komision, pasi që e kemi pasur vështirë me gjetë rrugëdalje. Ne mundemi me ba një amendament të mirë që përkrah prodhimet vendore dhe secili prej nesh është në favor të kësaj, por e kuptova shumë mirë debatin që është zhvillue dhe se qka ne duhet të votojmë dhe shpeshëherë po vijmë në këso situata me miratimin e ligjeve. Unë besojë se të gjithë jemi për me gjetë një modul për këtë dhe po e dijmë se qfarë është mirë, por jemi në disa situara që duhet me votue siç kërkohet.

Albana Fetoshi: qështja siç është propozuar në projektligj nuk është e qartë, qfarë ndodh me dy kompani vendore që konkurojnë për ta fitu tenderin, kur njëra konkuron me prodhim vendor e tjera jo. Amendamenti im ka për qëllim së në qdo rast kur ofertuesi konkuron për me fitu tenderin atëhere ti jepet përparësi prodhuesit vendorë kur ai ekziston. Ju e përemendët konkurrcën e lirë të tregut, por pikërisht prodhuesit vendor nuk janë të barabartë në këtë konkurrim, për shkak se ne si vend prodhojmë shumë pak, dhe pikërisht pse janë pak, prodhuesit vendorë janë të dëmtuar me rastin e tenderimit. Janë të pabarabartë në këtë konkurrencë sepse po ngulfaten nga prodhimet e shumta të huaja që e kanë vërshtuar tregun tonë, si pasojë e prodhimit të pakët vendor. Për fund, nëse komisioni del me një qëndrim të përbashkët dhe e formulon një amendament të tillë që është për t’u dhënë përparësi prodhuesve vendor në rastin e tenderimit, unë e tërheq amendamentin tim në seance kur të votohet amendamenti i komisionit. Për neve nuk ka rëndësi se kush është autor i këtij amendament, me rëndësi është që të ndihmohen prodhuesit vendor.

Kryesuesi konstatoi se amendamenti i propozuar nga deputetja Albana Fetoshit, me një votë Për (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami), dhe pesë Kundër (Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama), nuk përkrahet nga Komisioni funksional.

Kryesuesi konstatoi se me Dy vota Kundër (Albana Fetoshit dhe Hykmete Bajrami), dhe pesë Për (Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama), dhe asnjë Abstenim, miratohet propozimi i Zyrës së Kryeministrit, që në nenin 1, në paragrafin 1 dhe 2, pas fjalës “ofrojnë shërbime”, të shtohet fjala “kontratë furnizimi”.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri propozoi ndryshimin e nenit 3, me tekstin si në vijim:
“Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë

Raport me rekomandime

Komisioni shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe raportin me amendamente e procedon për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme, sipas kompetencës së tyre.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Naser Osmani: thekson se se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional janë pa implikime buxhetore shtesë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion

Naser Osmani: thekson se edhe ky projektligj dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikimebuxhetore shtesë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme.

Naser Osmani: theksoi se duhet të caktohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për inspektoriatin e doganës dhe administratës tatimore të Kosovës, i cili është miratuar në senacë plenare në lexim të parë më datë 30.01.2014, dhe për të cilin jemi komision funksional.

Në bazë të propozimeve, anëtarë të grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për inspektoriatin e doganës dhe administratës tatimore të Kosovës, u caktuar këtë anëtarë: Hykmete Bajrami (kryesuese), Hasime Krasniqi dhe Albana Fetoshi.

Mbledhja përfundoi: 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendës-kryetari i parë i Komisionit

Naser Osmani